

VENDIM
Nr. 773, datë 13.12.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË FUNKSIONIMIT DHE DETYRAVE
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË VITIVINIKULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 86/2022, “Për vreshtarinë dhe verën”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë rregullat e funksionimit dhe detyrat e Këshillit Kombëtar të Vitivinikulturës, si organ konsultativ.

2. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 86/2022, “Për vreshtarinë dhe verën”.

II. FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË VITIVINIKULTURËS

1. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Vitivinikulturës (në vijim Këshilli) janë të mbyllura dhe thirren nga kryetari, si rregull 4 (katër) herë në vit, në bazë të informacionit të marrë nga struktura përgjegjëse. Këshilli mund të mbledhet edhe kur shumica e anëtarëve paraqet kërkesë me shkrim, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje ose kur ka propozime, ndryshime të politikave ose akteve ligjore dhe nënligjore, që lidhen me vreshtarinë dhe verën.

2. Njëri nga anëtarët e Këshillit, si përfaqësues i ministrisë, zgjidhet sekretar.

3. Anëtarët e Këshillit njoftohen me shkresë zyrtare ose elektronike për datën dhe agjendën paraprake të mbledhjes, të paktën 7 (shtatë) ditë pune para ditës së mbledhjes.

4. Me përjashtim të pikës 3, të këtij kreu, kryetari mund të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit, brenda një periudhe më pak se 7 (shtatë) ditë pune nga dita e mbledhjes, në rast të:

a) detyrimeve të parashikuara për raportime që mund të kërkohen nga një shtet anëtar në Bashkimin Evropian ose çdo vend tjetër lidhur me sektorin e vreshtarisë dhe verës;

b) hyrjes në fuqi të akteve të reja ligjore dhe nënligjore në fushën e verës dhe vreshtarisë;

c) problematikave të tregut të verës;

ç) kërkesave nga prodhues, përpunues ose tregtar të produkteve të verës.

5. Kryetari mund të paraqesë në rendin e ditës të mbledhjes çështje të tjera, që nuk janë të përfshira në agjendën e paraqitur paraprakisht, nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm.

6. Kuorumi i nevojshëm për realizimin e mbledhjes së Këshillit realizohet kur marrin pjesë të paktën 6 (gjashtë) prej anëtarëve, përfshirë kryetarin dhe sekretarin.

7. Procedura për mbledhjen e Këshillit është, si më poshtë vijon:

a) Mbledhja hapet nga kryetari, i cili kërkon miratimin e agjendës paraprake me ndryshimet, nëse ka;

b) Sekretari paraqet verbalisht përpara Këshillit një pasqyrë të përmbledhur të kërkesave të palëve, të fakteve dhe të provave të depozituara para fillimit të shqyrtimit të çështjeve dhe mban procesverbalin e mbledhjes dhe diskutimeve të anëtarëve;

c) Kryetari shtron për diskutim të gjitha çështjet me radhë, që janë vendosur në agjendë;

ç) Kryetari fton anëtarët të votojnë në përfundim të të gjithë procedurës së shqyrtimit dhe të shkëmbimit të opinioneve. Asnjë nga anëtarët nuk mund të abstenojë nga vendimmarrja. Votimi është i hapur në të gjitha rastet. Mendimi i anëtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me propozimin dhe nënshkruhet me fjalën “kundër”;

d) Propozimet e Këshillit miratohen me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm;

dh) Kryetari merr masa, që në fund të takimit, të përgatisë një propozim të arsyetuar për ministrin, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votimin e tij;

e) Dokumentacioni i prodhuar gjatë të gjithë takimeve i nënshtrohet rregullave në fuqi për arkivin.

III. DETYRAT E KËSHILLIT KOMBËTAR TË VITIVINIKULTURËS

1. Detyrat e kryetarit të Këshillit përfshijnë:

- a) organizimin dhe drejtimin e punës së Këshillit;
- b) thirrjen e mbledhjeve të Këshillit;
- c) kryesimin e mbledhjeve të Këshillit;
- ç) përcaktimin e agjendës paraprake të mbledhjeve të Këshillit;
- d) dërgimin e propozimit për ministrin të struktura përgjegjëse;
- dh) konsultimin e propozimeve, me kërkesë të ministrit.

2. Detyrat e anëtarëve të Këshillit përfshijnë detyrat e përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr. 86/2022, “Për vreshtarinë dhe verën”, si dhe:

a) propozime për ndryshime ligjore ose rregullatore, që ndikojnë drejtpërdrejt në sektorin e vreshtarisë dhe verës;

b) formulimin e propozimeve konkrete në fushën e vreshtarisë dhe verës, që lidhen me kërkesat e tregut ose të prodhuesve/përpunuesve/tregtarëve;

c) dhënien e mendimeve dhe propozimeve konkrete për mundësimin e regjistrimeve të verërave cilësore;

ç) propozimin e një kalendari aktiviteteve promovuese në fillim të çdo viti, brenda dhe jashtë vendit.

3. Struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në ministri, në rolin e sekretariatit të Këshillit, kryen detyrat, si më poshtë vijon:

a) merr masat për sigurimin e logjistikës së nevojshme për realizimin e mbledhjeve të Këshillit, pas marrjes së njoftimit nga kryetari;

b) përcjell propozimet përkatëse të Këshillit te ministri;

c) u komunikon anëtarëve me *e-mail* orën dhe datën e mbledhjes, së bashku me rendin e ditës;

ç) mban të gjithë dokumentacionin e Këshillit, ku përfshihen të gjitha kërkesat dhe propozimet për ministrin dhe/ose grupet e interesit.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2025.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku